




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2 shkronja d, neni 40, paragrafi 40.2, pika d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), lidhur me nenin 6 të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.151/2020, për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të Institucionit Publik, nenin 35, paragrafi 35.2, pika d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 28.09.2022, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit, për intervistim, vlerësim dhe poentim të kandidatëve të cilët kanë konkurruar në konkurset publike për pozitat drejtor, zëvendës drejtor të shkollave filllore-mesme dhe çerdheve të fëmijëve të Komunës së Vitisë

Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për formimin e komisionit-panelit intervistues për intervistim, vlerësim dhe poentim të kandidateve të cilët kanë konkurruar në konkurset publik për pozitat drejtor, zëvendës drejtor të shkollave filllore-mesme dhe çerdheve të fëmijëve të Komunës së Vitisë,

Neni 2

Kuvendi i Komunës së Vitisë cakton që komisioni (paneli intervistues) të ketë këtë përbërje:

1. Kryetar komisionit: Zjadin Ahmeti
2. Anëtar i komisionit: Vjollca Zejnullahu
3. Anëtar i komisionit një përfaqësues nga MASHT-

Neni 3

Detyrat e komisionit panelit intervistues janë: intervistimi, vlerësimi, poentimi i kandidatëve të cilët kanë konkurruar në konkurset publike për pozitat e lartë cekura.

Neni 4

Periudha kohore e mandatit të komisionit do të jetë një (1) vit nga momenti i miratimit të këtij vendimi.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit; Drejtoria për Arsim e Komunës së Vitisë.

Neni 6

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 8 lidhur me nenin 9 të Rregullores Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Anëtarëve të komisionit;
2. zyrës së Kryetarit;
3. Drejtoria për Arsim; dhe
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
K R Y E S U E S I

Bekim Azizi

